



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
ËKomuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
611-23-11834-5-3-6/C715



KONTRATË PUNE

Emri i Projektit: **Gëlqerosja e brendshme e të gjitha objekteve shëndetësore të KPSII-së Drenas**

Numri identifikues: **611-23-9023-1-3-6**, Datë:05.12.2023, Nr. i arkivit; 02.400.58598

PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - Drenas, përfaqësuar nga **GEZIM HAJDINI** Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënës").

IDEOR CONSTRUCTION " SH.P.K.: përfaqësuar nga **DURIM SHALA**, Drejtor (më tutje kontraktuese).

Neni 1 Ligji i zbatueshem

Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë: **Gëlqerosja e brendshme e të gjitha objekteve shëndetësore të KPSII-së Drenas**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të punëve do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹. Periudha e kryesjes së punëve do të jetë deri në afatin :15 dite.

Neni 3 Çmimi

Çmimi i punëve është në shumën prej: **5,990.00 €**; (Pesë mijë e Nentëqindë e Nentëdhjetë Euro)

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton Menaxheri i projektit, duke mos e tejkaluar shumën prej: **5,990.00€**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda 30 ditëve

se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Kryetari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranim i caktoj në Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së punëve duhet të jetë brenda 6 dite. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor, Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen DSHPE.

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të punëve të kryera do të caktohet nga menaxheri i kontratës. Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga menaxheri i kontratës.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për punëve të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranim, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit, dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Drejtoria e Shëndetsise.

Neni 7 Garancioni i punëve

7.1 Nuk ka .

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentet, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk leshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërprese kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërprese kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.





13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi menjehere pas nënshkrimit.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GEZIM HAJDINI	Emri:	Durim Shala
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.12.2023	Data:	05.12.2023
Vula:		Vula:	

Për: KOMUNA GLLOGOC

(në vazhdim: "autoriteti kontraktues").

Në emër të: "IDEOR CONSTRUCTION" SH.P.K.

(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Gëlqerosja e brendshme e të gjitha objekteve shëndetësore të KPSH-së

Drenas Numri i Prokurimit: 611-23-11834-5-3-6

Garancion me kërkesë te pare

DERISA kontraktori i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE kontraktori obligohet të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar sipas Dosjes se tenderit ne rast qe Kontraktori dështon te përmbush obligimet sipas marrëveshjes;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim Kontraktorit këtë siguri:

NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, pa asnjë kusht shtese përveç atyre te cekura me poshtë, deri në një total prej: **599.00€ (Pese qind e nente dhjete e nente Euro 00/100cent)**, në emër të kontraktorit ne favor te Autoritetit Kontraktues, si siguri qe blerësi do përmbush te gjitha obligimet kontraktuale sipas marrëveshjes, ne rast qe blerësi dështon ti përmbushë obligimet e tij.

Ne zotohemi të ju paguajmë, shumen e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, deri ne maksimumin e limitit te cekur me larte, qe me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën ju deklaroheni:

- që bazuar ne gjykimin tuaj, Kontraktori ka dështuar te përmbush obligimet kontraktuale sipas marrëveshjes.
- për shumen qe bazuar ne gjykimin tuaj Autoriteti Kontraktues kërkon te ekzekutohet nga mos përmbushja e obligimeve kontraktuale

Pagesa në shumën e limituar prej: **599.00€ (Pese qind e nente dhjete e nente Euro 00/100cent)** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kërkesa e juaj duhet te shoqërohet me polisen origjinale dhe te dorëzohet ne kopje fizike.

Kjo siguri vlen nga 05.12.2023 deri me 18.01.2024



Nënshkrimi dhe vula e garantuesit
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A.
Rr.Ukshin Hoti nr.19, Prishtine
Date: 05.12.2023
Polica nr. 070010750015908



Garanci Ekzekutimi



Serial\ 070010750015908

Për **KOMUNA GLLOGOC**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

"IDEOR CONSTRUCTION" SH.P.K.

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marre përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Gëlqerosja e brendshme e të gjitha objekteve shëndetësore të KPSH-së Drenas

të dhënë me numrin e Prokurimit.

611-23-11834-5-3-6

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

€ 599.00

Pesë qindë dhe Nentëdhjetë dhe Nënt €

(shuma e garancisë në shifra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoritetit kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

€ 599.00

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen (shuma e garancisë)

arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

05.12.2023

deri më

18.01.2024

Lëshuar në

Drejtoria Qendrore


datë

05.12.2023

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA
Agjenti: Besnik Jashari

PARAMASA DHE PARALLOGARIA PER GELQEROSJEN E BRENDSHME TE GJITHA OBJEKTEVE TE KPSH - së - Drenas					
Përshkrimi i aktiviteteve					
Nr. R.	Lloji i punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Çmimi total (Euro)
1	I PUNËT PERGADITORE DHE NGJYROSJA				
1.1	Inqizimi i terrenit, definimi i sipërfaqes, mobilizimi i ndërmarrjes për aktivitet të punimeve, pastrimi i terrenit.	m ²	3,300.00	0.10 €	330.00 €
1.2	Identifikimi i sipërfaqeve të demtuara me (myk) në pjeset e objekteve ne QKMF si dhe largimi i mykut nga sipërfaqja e murit	m ²	100.00	2.10 €	210.00 €
1.3	Rregullimi i pjeseve të sipërfaqeve te demtuara ne pjesen ku do te behet ngjyrosja.	m ²	250.00	2.00 €	500.00 €
1.4	Furnizimi me material dhe lyerja e mureve te brendshme dhe pllafoneve me nje shtrese bazë dhe dy shtresa ngjyrë të bardhë. Verejtje ; Paraprakisht duhet të mbulohen me foli dyshemet, inventari dhe gjesendet tjera, në menyrë që mos të sterpiken me ngjyrë. Elementet e sterpikura duhet të pastrohen para se ngjyra të thahet, në të kundërt duhet te nderrohen ne të reja	m ²	3,300.00	1.50 €	4,950.00 €
				Totali 1:	5,990.00 €
REKAPITULLIM					
Nr. R.	Pozicioni	VLERA (Euro)			
1	I PUNËT PERGADITORE DHE NGJYROSJA	5,990.00 €			

Plani dinamik përfshin periudhën prej 15 ditë pune për vitin 2023	
<p>Të gjitha punët duhen të kryhen sipas ligjit të ndërtimit dhe normave teknike në fuqi të aplikueshme në Kosovë si dhe për çdo pozicion obligohet punëkryesi të sjellë atestet, certifikatat e materialeve si dhe shqyrtimet e tyre sa herë që kërkon organi mbikqyrës - menaxheri i projektit dhe janë të cekura në kontratë. Po ashtu për të gjitha pozicionet parashihet furnizimi me material dhe vurja në vepër.</p>	
Identifikimi i Operatorit Ekonomik (O.E)	
Emri i OE:	IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të O.E	DURIM SHALA
Nënshkrimi:	
Data:	03.11.2023
Vula:	
<p>Të gjitha materialet e listuara për ekzekutim në projekt duhet të jenë të çertifikuara sipas standardeve konform specifikimit teknik ISO, DIN, ENI ose ekuivalente.</p>	